



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori Zhvillimit Rural

Nr. 223 / prot:

Puke, me 24 / 11 .2020

PROJEKT - VENDIM

Per miratimin per heqje nga fondi pyjor publik te siperfaqes 0.8903ha qe do te perdoret per ndertimin e " Hec Gojan " Lumi fan I Madh nga shoqeria "MC ENERGY GOJAN shpk Bashkia Puke

Keshilli I Bashkise Puke ne mbledhjen e radhes te dates _____ ne zbatim te nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1, 2, germa 'a', neni 54, germa 'c', neni 55 pika 4 te ligjit nr .139/2015, date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen Vendore" I ndryshuar Ligji nr 48/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjinnr.9385 ,date 04.05.2005" Per pyjet dhe sherbimin pyjore "I ndryshuar: ne baze te VKM nr 591 date 9.10.2018 Per disa ndryshime ne vendimin nr 1353 date 10.10.2008 "dhe shkrese se Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit nr prot 7396 date 05.11.2020 per dhenjen e dakortesise per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor V.K.M Nr 433, date 08.06.2016" Per transferimin sipas listes s inventarit te pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht ne administrimin e Ministrise se Mjedisit dhe ish komunave/Bashkive ne pronesi te Bashkive,.Udhezimin te Ministrise se Mjedisit nr 01 date 09.06.2016" Per rregullat ,procedurat e kerkimit ,te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjor public nga ana struktures pergjegjese per pyje :Me propozim te kryetarit Bashkise: Keshilli I Bashkise pas shqyrtimit

V E N D O S I

1. Miratimin e kerkeses per heqjen nga fondi pyjor te siperfaqes prej 0.8903 ha nga ana e Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit
2. Siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor jane percaktuar ne raportin mbi studimin tekniko- ekonomik per dhenje ne perdorim/heqje nga fondi pyjore per ndertimin "Hec Gojan" nga shoqeria "MC ENERGY GOJAN shpk Bashkia Puke Parcela nr 67/a siperfaqja qe do te hiqet 0.8903 ha.
3. Per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor te zbatohet V.K.M nr 591 date 09.10.2018

Pika "ç) Miratimin e shkrim per vazhdimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor me vendim te keshillit Bashkiak,brenda territorit administrative te te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nenshtrohet procedurave te heqjes nga fondi pyjor." dhe shkrese se Ministrise e Turizmit dhe Mjedist nr prot 7396 date 05.11.2020 per dhenjen e dakortesise per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor

- 4 .Per vashdimin e procedurave sipas percaktimeve te Udhezimit nr 2/2016 te Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit,ngarkohet seksioni I pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Puke zyra kadastres pyjore
5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Sektori I zhvillimit rural ,Seksioni pyjeve dhe kullotave
6. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore"

HARTUESI

Ing Astrit Hyseni



JURISTI

Aida Sinani



KRYETARI

Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori I Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 923/prot

Pukë, më 24.11.2020

RELACION

PER MIRATIMIN ME SHKRIM PER VIJIMIN E PROCEDURAVE TE HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIK TE NJE SIPERFAQE PREJ 0.89 HA NGA ANA MINISTRISE TURIZMIT DHE MJEDISIT PER NDERTIMIN "HEC GOJAN" FAN I MADH NGA SHOQERIA "M.C ENERGY" Sh.p.k

DREJTUAR :Keshillit Bashkiak Puke

Te nderuar keshilltare

Administrimi I fondit pyjore kullosore ne Bashkine Puke eshte nje nga funksionet I percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ku ne piken 5 te ketij neni percaktohen funksionet e Bashkive ne fushen e Bujqesise zhvillimit rural pyjeve dhe kullotave publike ,natyres dhe biodiversitetit .Bashkite jane pergjegjese per kryerjen e ketyre funksioneve:pika 5 administrimi I fondit pyjore dhe kullosor eshte ligji nr 9693/2017 "per "fondin kullosor I ndryshuar " si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij ,ne zbatim te neneve 15 dhe 17 te ketij ligji ka dale udhezimi I Ministrise Mjedisit nr 01 date 09.06.2016"Per caktimin e kriterëve per dhenje/heqje ne perdorim te fondit pyjore

Bazuar ne udhezimin e mesiperm dhe ne kerkesen e bere nga ana shoqerise "M.C ENERGY " Sh.p.k drejtuar Bashkise Puke NR 17 Prot Date 03.06.2020 PER NDERTIMIN E HEC "HEC GOJAN" FAN I MADH pas marrjes NR 100/7 DATE 27.12.2017 dhe shkreses Mbështetur ne kontraten koncesioni e forms"BOT" Nr 25/5 Rep ,Nr 118/2 Kol (NDERTIM-OPERIM-TRANSFERIM) per objektin dhenje me koncesion per ndertimin e burimit te ri gjenerues te energjise te hidrocentralit Gojan nga ana e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastrat/nëngastra 1,2/c 2/a,4b,4/d,6/c,8,9,10/b,13/b,13/c,14/f,14/a,17/b,,bëjnë pjesë në

ekonomitë pyjore/kullosor "Gjegjan Skoze" dhe nenegastra 67/a te ekonomise pyjore Lumi I zi dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 ne baze te kerkeses drejtuar Bashkise Puke me shkresen nr prot 12 date 03.06.2020 ku kerkohet pergatitje e raportit tekniko-ekonomik te vleresimit financiar per ndertimin e hec Kaulina . Pas marrjes se kerkese nga ana Bashkise Puke eshte ngritur grupi I punes perbere nga dy ingjineret pyjeve dhe eshte shkuar ne terren dhe eshte percaktuar qarte gjurma ne te cilen do te kaloj hec Gojan lumi Fan I Madh ne bashkine Puke dhe eshte hartuar raporti tekniko-ekonomik I vleresimit financiar ku dhe jane percaktuar siperfaqet pyjore qe do te jepen ne perdorim dhe siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor kullosor dhe volume I materialit drusore qe do te demtohet nga punimet .

Duke u bazuar ne V.K.M nr 591 date 09.10.2018 per disa ndryshime per vendimin nr 1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave "Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses mbajtjes dhe plotesimit e dekontacionit teknik,si dhe te kritereve e procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjore" te ndryshuar pika ç kerkohet miratimi me shkrim per vashtimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor me vendim te keshillit Bashkiak Brenda territorit administrative te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nenshtrohet procedurave te heqjes nga fondi pyjor nga ana Ministries Turizmit dhe Mjedisit Ne menyre te permbledhur per heqjen nga fondi pyjore jane keto siperfaqe pyjore ne keto ekonomi pyjore ne territorin e Bashkise Puke

- Ekonomia Pyjore Lumi I zi parcela nr 67/a siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjore eshte 0.8903 ku do te ndertohet vepra marrjes nr 1+dekantues+bazebi e hec Gojan

Duke ju falenderuar ju ftojme ne miratimin e project vendimit per vijimin procedurave nga ana Ministrise Turizmit dhe Mjedisit ku kerkohet miratimi me shkrim nga ana keshillit Bashkiak per vijimin e procedures se heqjes nga fondi pyjor ne baze baze te V.K.M 591 date 09.10.2018

P/ Sektorit Zhvillimit Rural

Astrit Hyseni



Shoqeria

"M.C ENERGY GOJAN" Sh.p.k.

date 03.06.2020

Nr. 17 Prot.

Nga : M.C. ENERGY GOJAN

Drejtuar: Bashkia Puke

Lenda: Kerkese per marrje ne perdorim dhe heqje nga fondi pyjor per "HEC-GOJAN"- Lumi Fani Madh

Ne baze te VKM nr.822 date 07.10.2015 si dhe te ligjit nr.43/2015, "Per sektorin e energjise elektrike", "M.C. ENERGY GOJAN" Sh.p.k., ka lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontraten e Konçensionit BOT (ndërtim-Operim-transferim) Nr.2515 Rep, Nr.1181/2 Kol, datë 06 Nëntor 2017 ne lumin Fani Madh, Bashkia Puke, Qarku Shkoder.

Bazuar ne nenin 17 te ligjit nr.9385 date 04.05.2005 "PER PYJET DHE SHERBIMIN PYJOR" te ndryshuar, si dhe VKM nr.1353 date 10.10.2008 "Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kriterëve dhe proceduarave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor", po aplikojme prane institucionit tuaj per te realizuar marrjen ne perdorim dhe heqjen e nje pjese nga fondi pyjor te siperfaqes mbi te cilen shtrihet objekti.

Te dhenat:

Kerkuesi: M.C Energji Gojan
Veprimtaria: Hidrocentral me derevacion
Vendodhja: Puke, Lumi Fani Madh
Ekonomia pyjore: Gojan-Shkoze
Siperfaqja per heqje: 0.8903 HA
Siperfaqja ne perdorim: 0.4522 HA

Bashkengjitur jane:

CD me te gjithë dokumentacionin,
Lista e detajuar me parcelat ku shtrihet objekti,
Planimetria e gjeoreferuar me hartat pyjore,
Miratimi ne parim nga MIE,
Licensat e studios se projektimit,
Ekstrakt,
Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis,
Relacioni teknik,
Projektin e ndertimit

Duke ju falenderuar paraprakisht per bashkepunimin ju urojme pune te mbare.

"M.C. ENERGY GOJAN" Sh.p.k.

Administratori

Mark LULI

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

NR. 2 Rep.
NR. 2 Kol.



TAKSAE PULLES
U PAGUA

KONTRATË SHITESË KONCESIONI

PËR
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS "BOT"
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM) PËR OBJEKTIN "DHËNIE ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT GOJAN".



Në Tiranë, më datë 03 muaji Janor, viti 2019 (dymijë e qind e traj para meje
noter Blendi Jovoda anëtar i dhomës së Noterisë (uau), me adresë
Blendi Jovoda u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues,
përfaqësuar me Autorizimin nr.14504 prot, datë 03.12.2018, nga Znj. Etleva Kondi e
datëlindjes 29.3.1972, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës
u sigurova nga Leternjoftimi ID me nr. personal H25329143H, nr. Leternjoftimi 028001010

DHE

Shoqëria "M.C. Energji Gojan" Sh.p.k, themeluar si person juridik datë 15.08.2017 dhe
rregjistruar në QKB datë 21.08.2017, me NUIS L72021019A, e përfaqësuar ligjërisht nga
administratori i shoqërisë Z. Mark Luli i datëlindjes 08.01.1962, madhor dhe me zotësi
juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit
pasaport me nr. personal G20108139M,

të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë konçesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Konçesionit të
formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Gojan", lidhur ndërmjet Ministrisë së
Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k me Nr. 2515 Rep.
& Nr. 1181/I Kol, hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 06 Nentor 2017.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Ndërmjet Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë dhe shoqërisë "M.C. Energji Gojan"
sh.p.k (Konçesionari) është lidhur Kontrata e Konçesionit e formës "BOT" për ndërtimin

Neni 2

Neni 3, "Karakteristikat e hidrocentralit", ndryshohet si më poshtë:

Hidrocentrali "Gojan", i cili do të shfrytëzojë potencialin hidroenergjetik të pellgut ujëmbledhës të lumit "Fani i Madh" do të ketë karakteristikat teknike vijuese:

Hidrocentrali "GOJAN"

- Kuotat e veprave :
 - Kuota e veprës së marrjes 427.5 m.m.n.d.
 - Kuota e godinës së centralit 310.0 m.m.n.d.
- Fuqia e instaluar N= 15,000 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike E= 47,800,000 kWh/vit

Parametrat hidroenergjetike totalë do të jenë :

- Fuqia totale e instaluar 15,000 kW
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 47,800,000 kWh/vit

Projekti i zbatimit mund të pesoje ndryshime të mundshme, me marrveshje ndërmjet palëve në variantin përfundimtar të projekt zbatimit, i cili mund të përmirësohet, por duke ruajtur të pandryshuar kuotat ekstreme dhe termat e përcaktuara në këtë marrëveshje si dhe duke garantuar mirefunksionimin apo mos cenimin e objekteve të bujqesisë dhe koncesionare që përfshihen në kete pellg ujëmbledhës.

Neni 3

Në nenin 8 "Detyrimet e koncesionarit" në pikën 8.5, shprehja "...me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 8,900 kW", zëvendësohet me shprehjen "...me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 15,000 (pesëmbëdhjetemijë) kW".

Neni 4

Neni 9 "Vlerësimi i investimeve", pika 9.1 ndryshohet si më poshtë:

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 2,680,656,000 (dymiliard e gjashtëqindetëdhjetemilion e gjashtëqindpesëdhjetegjashtëmijë) leke (pa TVSH), sipas preventivit bashkëlidhur kësaj kontrate shtesë. Ky preventiv përfshin dhe vlerën që do të investohet në makineri pajisje.

FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES

Çertifikata e Garancise nr. 017677/2017

Data 22.08.2017

Per: Ministria e Energjise dhe Industrise
Blvd. Deshmoret e Kombit nr 1001, Tirane

Duke qene se:

- Shoqeria M.C. ENERGJI GOJAN Sh.p.k me adrese: Rruga "Nexho Konomi", Zona Kadastrale 3866; Nr. Pasurie 306/113, me NIPT: L72021019A (ketu e me poshte eshte "Koncesionari") eshte shpallur fitues ne Proceduren Konkufuese per Dhenien me Koncesion te Hidrocentralit "Gojan", me vendndodhje ne Gojan, Puke, sipas shkreses se Ministrise se Energjise dhe Industrise (me poshte referuar se "Autoriteti Kontraktor") Nr. 4513/2 Prot, date 09.08.2017, "Njoftimi per ofertuesin e kualifikuar"; dhe

- Ofertuesi fitues ka paraqitur prane nesh dokumentacionin e kerkuar per projektin Dhenien me Koncesion te Hidrocentralit "Gojan", ne Gojan, Puke, dhe

- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne Dhenien e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te garancikuara ne kontrate, dhe

- Kompania e Sigurimeve INTERSIG Vienna Insurance Group eshte dakort te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:

- Jemi garantuesit e kontrates se siperpermendur, deri ne shumen totale prej 234.542.558 leke (dyqind e tridhete e kater milion e peseqind dyzet e dy mije peseqind pesedhete e tete leke) shume e cila eshte e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate; dhe

- marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej 234.542.558 leke (dyqind e tridhete e kater milion e peseqind dyzet e dy mije peseqind pesedhete e tete leke), dhe



INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP sh.a.
Rr. "Ismail Qemali", Samos Tower,
Kati 2-te, Ish-Bloku, Tirana, Albania
+355 (0) 4 22 70 576

INTERSIG

SHTESE E FORMULARIT I SIGURIMIT TE KONTRATES ME NR 017677/2017

Certifikata e Garancise nr. 18922/2018

Data 24.12.2018

**Per: Ministria e Energjise dhe Industrise
Blvd. Dëshmoret e Kombit nr 1001, Tirane**

Duke gene se:

- Shoqeria M.C. **ENERGJI GOJAN** Sh.pik me adrese: Rruga "Nexho Konomi", Zona Kadastrale 3866, Nr. Pasurje 306/113, me NIPT: L72021019A (ketu e me poshte eshte "Koncesionari") eshte shpallur fitues ne Proceduren Konkruese per **Dhienien me Koncesion te Hidrocentralit "Gojan"**, me vendndodhje ne Gojan, Puke, sipas shkreses se Ministrise se Energjise dhe Industrise (me poshte referuar se "Autoriteti Kontraktor") Nr. 4513/2 Prot. date 09.08.2017, "Njoftimi per ofertuesin e kualifikuar", dhe
- Ofertuesi fitues ka paraqitur prane nesh dokumentacionin e kerkuar per projektin Dhienien me Koncesion te Hidrocentralit "Gojan", ne Gojan, Puke, dhe
- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne kontrate, dhe
- Kompania e Sigurimeve **INTERSIG Vienna Insurance Group** eshte dakort te leshoje kete garanci.

Deklarojme se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT NË FUSHËN E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

14504

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 03.12.2018

AUTORIZIM

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë", Titulli II, kreu I (përfaqësimi), i ndryshuar, pikës 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, autorizoj znj. Etleva Kondi, Drejtor në Drejtorinë e Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë, për firmosjen e Kontratës Shtesë të Koncesionit "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Gojan", ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "M.C Energji Gojan" shpk.

MINISTËR

Damjan Gjijnuri

